



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË

Nr. 220 Regjistri Themeltar

Nr. 534/6 Vendimi

Date 08.11.2022 Regjistrimi

Date 23.06.2023 Vendimi

VENDIM

PËR DEPOZITIM NË REGJISTRIN E SHOQATAVE

Sot, më datë 23.06.2023, unë **Julian Haxhiu**, Gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, mora në shqyrtim kërkesën dhe aktet e paraqitura nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), i cili kërkoi depozitimin e vendimit datë 29.10.2022 të Asamblesë së 27-të të Përgjithshme Zgjedhore të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar.

KONSTATOVA

Se Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është regjistruar në Regjistrin e OJF-ve si person juridik në formën e shoqatës, me anëtarësi, me Vendimin Nr. 5934, datë 22.06.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me statutin dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Asambleja e 27-të e Përgjithshme Zgjedhore e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar më datë 29.10.2022 ka vendosur:

Ratifikimin e vendimeve të marra në Asamblesë e fundit të KOKSH mbajtur më datë 28 Maj 2022.

Miratimin e Logos të re të KOKSH sipas certifikimit nga IOC.

Ndarja e Cmimeve "Urdhëri Olimpik".

Gjergj Ruli

Gazmend Caci

Zgjedhja e 4 (katër) anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv të KOKSH, për të plotësuar vendet vakante me mandate që përfundojnë në vitin 2025.

Alfred Tahiraj

Dritan Shakohoxha

Julinda Dhame

Tonin Binoshaj

Zgjedhja e 3 (tre) anëtarëve themelues të KAS të cilët do të jenë dhe anëtarët e parë të organit më të lartë vendimmarrës të KAS që do të jetë Bordi Ekzekutiv.

Eralda Cani

Marjana Semini

Skënder Kaçupi

Gjykata raporton që në sekretarinë e gjykatës nga Federata Shqiptare e Futbollit është paraqitur kërkesa me nr. 3656 prot., date 29.05.2023 bazuar në nenin 189 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë për përfshirjen si palë ndërgjyqëse në çështjen gjyqësore me palë kërkuese: Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar me objekt kërkesë: "Depozitimi dhe regjistrimi Asamblesë së 28-të Përgjithshme Vjetore të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar" si dhe kërkesa me nr. 4272 prot., datë 20.06.2023 për pezullimin e regjistrimit të vendimeve të Asamblesë së Komitetit Olimpik Shqiptar (KOKSH) dhe vendimeve të marra prej saj bazuar në Nenin 189 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Nenet 39-53/1 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Ligji nr. 8788 datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", Ligji nr. 80/2021, "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", gjithashtu nga pala kërkuese Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar janë paraqitur prapësimet me nr. 4547 prot., date 21.06.2023 sipas të cilës kërkohet mospranimi i kërkesave të FSHF si të pambështetura në ligj dhe në prova, mirëpo gjykata pasi u njoh me kërkesat e paraqitura nga Federata Shqiptare e Futbollit si dhe me prapësimet e paraqitura nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar çmon të mos i pranohet kërkesat e Federatës Shqiptare të Futbollit për shkak se në këtë proces gjyqësor pa palë kundërshtare të karakterit deklarativ nuk mund të pranohen kërkesa për pranimin e subjekteve të treta pasi cënon karakterin gjyqësor të këtij procesi, palët nëse kanë pretendime ligjore procedurale në lidhje me aktet objekt shqyrtimi mund ti drejtohen gjykatës me padi themeli dhe me palë kundërshtare, ky argument ligjor qëndron si për kërkesën për përfshirjen si palë ndërgjyqëse si për kërkesën për pezullimin e procesit.

Mbështetur në nenet 189-190-191 parashikohet se pjesëmarrja e personave të tretë mund të bëhet vetëm në procese gjyqësore me palë të tjera, pra me palë kundërshtare dhe jo në këtë proces deklarativ për shqyrtimin e një kërkesë për depozitim aktesh të organizatave jofitimprurëse.. Depozitimi i Vendimeve për regjistrimet në regjistrin elektronik të gjykatës proceduralisht paraqet në formën e një gjykimi pa palë kundërshtare pra është një gjykim gracioz, pa kontencion.

Neni 29 i Ligjit Nr. 80/2021 Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse parashikon se

Pezullimi i shqyrtimit të kërkesës

1. Në rastet kur pas verifikimeve të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji rezulton se nuk janë përmbushur kushtet për regjistrim, nuk janë paguar tarifat përkatëse të regjistrimit apo nuk janë kryer veprimet e kërkuara sipas nenit 46 të këtij ligji, gjyqtari ose kancelari, sipas rastit, pezullon shqyrtimin e kërkesës dhe e njofton kërkuuesin me shkrim për shkakun e pezullimit, duke i dhënë një afat deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për plotësimin ose ndreqjen e të metave që pengojnë regjistrimin. Njoftimi i shkakut të pezullimit bëhet nëpërmjet një formulari standard sipas formatit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

2. Nëse kërkuesi plotëson ose ndreq të metat që pengojnë regjistrimin brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është e detyruar të kryejë regjistrimin brenda një afati prej 5 (pesë) ditësh pune nga data e plotësimit ose ndreqjes së dokumentacionit. Në këtë rast, regjistrimi mban datën e paraqitjes së kërkesës së parë për regjistrim.

Sa më sipër kërkesa për pezullimin e këtij shqyrtimi është një procedurë e posacme gjyqësore dhe nuk mund të aplikohen dispozitat 202 e në vijim të Kodit të Procedurës Civile. Për derisa nuk janë përmbushur kushtet dhe kriteret e Nenit 29 të Ligjit Nr. 80/2021 Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse, gjykata cmon të mos e marrë në konsideratë këtë kërkim procedural.

Vendimi i mësipërm datë 29.10.2022 i Asamblesë së 27-të të Përgjithshme Zgjedhore të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar është marrë pjesërisht në përputhje me statutin e shoqatës së Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), në përputhje me Ligjin Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” i ndryshuar, si dhe me Ligjin Nr. 8577, datë 10.2.2000 (ndryshuar me ligjin nr. 99/2016 dhe ligji nr. 45/2021) “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, pasi anëtarja që është zgjedhur Marjana Semini tashmë është anëtare e Gjykatës Kushtetuese. Mbështetur në nenin 16/a të këtij ligji qenia gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik dhe shkencor për zhvillimin e doktrinës.

Për sa më sipër, zgjedhja e kryer e tre anëtarëve të KAS vjen në kundërshtim me Ligjin Nr. 8577, datë 10.2.2000 (ndryshuar me ligjin nr. 99/2016 dhe ligji nr. 45/2021) “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” për njërin nga anëtarët e tij konkretisht për anëtarën Marjana Semini. Nuk është paraqitur asnjë deklaratë vullneti pranimit nga kjo shtetase në lidhje me këtë pozicion gjyqësor sportiv.

Sa më sipër kjo gjykatë sportive nuk mund të krijohet për aq kohë sa zgjedhja e 3 anëtarëve themelues nuk është e plotë sipas akteve përkatëse normative. Për pasojë pranohet pjesërisht kjo pikë e vendimit datë 29.10.2022 të Asamblesë së 27-të të Përgjithshme Zgjedhore të Komitetit

Olimpik Kombëtar Shqiptar, pasi vetëm anëtarët Eralda Cani dhe Skënder Kaçupi plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore për të qenë antarë të kësaj trupe gjyqësore sportive,

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjit nr.8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" i ndryshuar me ligjin nr.9814, datë 04.10.2007 e ligjin nr.92/2013, në mbështetje të ligjit nr.8789, datë 07.05.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 8577, datë 10.2.2000 (ndryshuar me ligjin nr. 99/2016 dhe ligji nr. 45/2021) "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

VENDOSA

Pranimin pjesërisht të kërkesës.

Depozitimin e Vendimit datë 29.10.2022 të Asamblesë së 27-të të Përgjithshme Zgjedhore të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, përsa i përket pikave 1,2,3,4.

Pranimin e pjesëshëm të pikës 5 të Vendimit datë 29.10.2022 të Asamblesë së 27-të të Përgjithshme Zgjedhore të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar për zgjedhjen e dy anëtarëve themelues të KAS dhe rrëzimin e kërimit për anëtarin Marjana Semini.


Urdhërohet Zyra e Regjistrimit e Organizatave Jofitimprurëse për pasqyrimin e ndryshimeve në kolonat përkatëse të regjistrimit.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Tiranë sot më datë 23.06.2023.

Vendimi mori forme te prere pasi
nuk u ankimua me dt 12.07.2023
Tirane me dt 28.07.2023

K / SEKRETAR
MIMOZA Tafa



GJYQATAR
Julian HAXHIU



Shpenzime gjyqësore	Pala që ka parapaguar/paguar shpenzimin gjyqësor				Sasi	Çmim	Vlerë
	Gjykata	Paditës/Kërkues	I Paditur	P.tretë			
Taksë kërkesë		1000			1	1000	1000
Shuma	0	1000	0	0			1000 Lekë